



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

# DITARI JAVOR

11 - 17 Nëntor 2019

## PROJEKTBUXHETI I SHTETIT 2020




## PROJEKTBUXHETI 2020 NË KOMISIONIN E LIGJEVE



## PAKETA FISKALE 2020




## TAKIM ME MISIONIN E FMN



## LUFTA KUNDËR INFORMALITETIT



## BB MBËSHTET SHQIPËRINË PËR BARAZINË GJINORE



## KONFERENCA PËR PASURITË E KONFISKUARA



## GARANTIMI I SIGURISË SË ASHENSORËVE



## PUNËSIMI PËRMES ZYRAVE TË PUNËS



Projektbuxheti 2020 mbështet reformat e qeverisë për rritje cilësore dhe të qëndrueshme të ekonomisë, rritje të punësimit dhe shërbimeve ndaj qytetarëve. Gjatë prezantimit në komisionin parlamentar për Ekonominë dhe Financat, Ministria Denaj u shpreh se Projektbuxheti synon realizimin e një rritjeje ekonomike në nivelin 4.1%, e gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet. Kjo rritje e parashikuar për 2020 do të përkthehet në më shumë punësim: krijimin e rreth 35 mijë vendeve të reja pune dhe uljen e mëtejshme të shkallës së papunësisë poshtë nivelin 11%. Projektbuxheti siguron një nivel të lartë të investimeve publike prej mbi 4.5% e PBB, në mbështetje të rritjes ekonomike dhe punësimit.

Komisioni parlamentar i Ligjeve shqyrtoi dhe miratoi në parim Projektbuxhetin 2020. Në fjalën e saj, Ministria Denaj theksoi se sektorët prioritarë që mbështetet nga Projektbuxheti 2020 janë arsimi, shëndetësia, bujqësia, dhe mbrojtja, ku financimet për vitin e ardhshëm do të jenë në rritje në krahasim me vitin 2019. Prioritet i Projektbuxhetit është edhe Reforma në Drejtësi, ku për vitin 2020 parashikohet që kostot vijuese dhe të reja të institucioneve të reja të drejtësisë të kapin një vlerë të konsiderueshme prej 2.9 miliardë lekë. Deputeti Bashkim Fino, i cili ishte dhe relator i Projektbuxhetit, vlerësoi në mënyrë të veçantë mbështetjen buxhetore për Reformën në Drejtësi dhe Arsim.

Projektligjet e Paketës Fiskale 2020 u prezantuan para deputetëve të komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Ministria Denaj vuri në dukje se Paketa nuk është një paketë tipike që do të sillte ndryshime në përlogaritjen e të ardhurave, por fokusohet në ndryshimet e disa ligjeve kryesore, si ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat"; ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"; ligjin "Për taksat kombëtare"; si dhe ligjin "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë". Një prej pikave kryesore të saj është incentivimi i sektorit të industrisë automotivë, ku norma e tatimit fitimit për sipërmarrjet që operojnë në këtë sektor parashikohet të jetë 5 %, nga 15% që është aktualisht. Paketa konsiston edhe në harmonizimin e disa dispozitave ligjore me përcaktimet e projektligjit për Fiskalizimin.

Ministria Anila Denaj zhvilloi takimin hapës me misionin e FMN, në kuadër të bisedimeve vjetore me FMN për ecurinë e ekonomisë së Shqipërisë, ku shprehu angazhimin e Qeverisë dhe MFE për reformën në menaxhimin e financave publike dhe konsolidimin fiskal. Ministria theksoi se zhvillimi i sektorëve prioritarë, ecuria e reformave në këto sektorë edhe me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë dhe përpjekjet sistematike kundër informalitetit dhe evazionit fiskal synojnë një zhvillim të ekonomisë reale me trend rritës në vazhdimësi në intervalin 3% – 3.5% për vitin 2019 dhe një reduktim të papunësisë nën nivelin aktual prej 11.2%. Mbështetja e FMN në hartimin e një Strategjie Afatmesme të të Ardhurave në Shqipëri, tashmë në proces, do të vijojë në mënyrë paralele me Reformën e Fiskalizimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka kryer **1432** kontrole gjatë periudhës 1-10 nëntor 2019, ku janë konstatuar **226** shkelje të legjislacionit tatimor. Shkeljet kryesore janë: **23** subjekte të paregjistruara në organet tatimore; **44** tatimpagues të penalizuar për shkeljen e moslëshimit të kuponit tatimor; **26** tatimpagues janë penalizuar pasi janë konstatuar me punonjës të padeklaruar; **13** tatimpagues janë konstatuar se nuk kanë pasur të instaluar pajisjet fiskale dhe **10** tjerë nuk i mbanin pajisjet fiskale në gjendje pune; **37** tatimpagues janë konstatuar se dispononin mallra pa dokumentacion tatimor.

Banka Botërore do të mbështesë Shqipërinë për të zgjeruar më tej barazinë gjinore duke rritur mundësitë ekonomike për gratë. Bordi Ekzekutiv i Drejtorëve të BB ka aprovuar huanë prej 10 milionë USD për Shqipërinë, financim i cili do të mbështesë përpjekjet e qeverisë për përmirësimin e barazisë gjinore përmes njohjes së bashkëpronësisë së gruas në pasuritë e paluajtshme, krijimit të mundësive për to në aktivitetet që gjenerojnë të ardhura, si dhe forcimit të politikave mbi barazinë gjinore. Ministria Denaj vlerësoi mbështetjen e BB dhe shprehu besimin se ky program do të ndihmojë në kapërcimin e pengesave që lidhen me punësimin dhe përfaqësimin e suksesshëm të grave në tregun e punës.

Konfiskimi dhe vendosja në dispozicion për përfitime sociale e pasurive nga burime jo të ligjshme mbetet një sfidat e rëndësishme për institucionet e përfshira në këtë proces. Ky ka qenë mesazhi që u dha nga Ministria Anila Denaj, gjatë fjalës së saj në konferencën mbi administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara. Ministria ftoi të gjithë aktorët të angazhohen për një bashkëpunim institucional më të gjerë për të bërë të mundur avancimin e kuadrit ligjvënës dhe atij zbatues për Sekuestrimin, Konfiskimin dhe Administrimin e Pasurive të fituara përmes kimit dhe në tërësi për Zbatimin e Plotë të Reformës në Drejtësi.

Të gjithë ashensorët që do të hyjnë në tregun shqiptar duhet të jenë në markuar me certifikatën e sigurisë, në mënyrë që të rritet siguria e qytetarëve dhe të garantohet përputhja e plotë me direktivat e Bashkimit Europian. Për këtë qëllim, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut zhvilloi një tjetër diskutimi me temë "Roli i ndërtuesve, importuesve, instaluesve dhe trupave të autorizuar për sigurinë që ofrojnë ashensorët", me aktorë të tregut privat dhe përfaqësues të organizatave civile që kanë në fokus mbrojtjen e konsumatorëve. Nga ana e drejtuesve të ISHMT u theksua se legjislacioni shqiptar tashmë është përshtatur sipas direktivave të BE-së dhe për zbatimin e tij do të duhet të angazhohen të gjithë palët e interesit.

**504** persona janë punësuar përmes zyrave të Punës në gjithë vendin gjatë periudhës 8-14 nëntor 2019. Numrin më të madh të të punësuarve e ka qarku i Tiranës me **174** persona, ndjekur nga qarku i Durrësit me **57** persona, qarku i Elbasanit me **46** persona, qarku i Beratit me **44** persona, qarku i Fierit me **37** persona, etj.